

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI**



Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2011

**KODI I ETIKËS
I UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

**Miratuar me Vendim nr. 12, datë 18.04.2011
të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës**

TIRANË 2011

KODI I ETIKËS

I UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Neni 1 **Baza ligjore**

Ky Kod është nxjerrë në zbatim të Ligjit nr.9741 datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit nr.9131 datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me fushën e veprimit të këtij kodi.

Neni 2 **Qëllimi**

Kodi i Etikës ka për qëllim të vendosë rregulla të sjelljes të personelit akademik dhe joakademik dhe të studentëve, sipas standarteve të vendosura, në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të universitetit dhe me lirinë akademike.

Neni 3 **Fusha e veprimit**

Kodi i Etikës është i detyrueshëm për zbatim në Universitetin e Tiranës, në Rektorat, në njësitë kryesore, bazë dhe ato ndihmëse që janë pjesë e këtij universiteti. Të gjithë punonjësit të cilët janë në marrëdhënie pune, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës së punës, personel akademik ose joakademik dhe administrativ, janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e këtij Kodi. Gjithashtu, këto dispozita janë të detyrueshme edhe për studentët që ndjekin programe studimi në U.T.

Neni 4 **Detyrimet e punonjësit**

Punonjësi i Universitetit të Tiranës, gjatë kryerjes së detyrës duhet të udhëhiqet nga parimi i përpikmërisë, korrektësisë, ndershmërisë, mirësjelljes, vullnetit të mirë, bashkëpunimit, solidaritetit, moralit të lartë dhe objektivitetit. Punonjësi i U.T. duhet:

- a. Të respektojë orarin e punës të vendosur nga punëdhënësi.
- b. Të ruajë një paraqitje serioze përpara studentëve dhe personave të tjerë, gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, përdorimin e një fjalori të zgjedhur dhe brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare.

- c. Të zbatojë me korrektësi detyrën dhe urdhërat e eprorit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.
- d. Të shfaqë sjellje të mirë, brenda normave të etikës qytetare e profesionale ndaj studentëve.
- e. Të shmangë rastet kur ka konflikt interesash sipas legjislacionit në fuqi, duke i deklaruar ato përpara eprorit, sapo të jenë shfaqur.
- f. Të mos lejojë që marrëdhëniet personale të prekin dhe të mos krijojnë përshtypjen se prekin marrëdhëniet profesionale. Ai duhet të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favore të tjera të cilat pedagogu mund t'i kryejë për shkak të detyrës.
- g. Të mos bëjë dallime ndër studentë, vartës apo kolegë për shkak të njohjeve apo preferencave personale.
- h. Të mos bëjë dhe të mos bëhet pre e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga studentë apo persona të tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me normat morale.
- i. Të kujdeset për pasurinë e institucionit dhe të mos e përdorë atë për përfitime personale. Kur ndërmerr punë konsulente private, pedagogu duhet të mos përdorë autoritetin që ka dhe të mos veprojë në emër të universitetit, si dhe të mos përdorë burimet pasurore publike të tij në aktivitetin privat.
- j. Të trajtojë në mënyrë të barabartë vartësit, kolegët dhe studentët, duke shmangur cënime të dinjitetit, të personalitetit dhe të mendimeve të tyre profesionale.
- k. Të mos konsumojë pije alkoolike apo duhan në ambjentet e institucionit.

Neni 5

Detyrimet e studentëve

Studentët kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e këtij Kodi për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit, si dhe të sillen në përputhje me normat etiko - morale të qytetarisë së mirë. Kështu studentët në ambjentet e U.T., duhet:

- a. Të zbatojnë orarin e mësimit dhe t'u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe në Rregulloren e U.T.
- b. Të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në ambjentet e institucionit, që nënkupton një veshje të përshtatshme, joekstravagante, si dhe përdorimin e një fjalori të përshtatshëm sipas normave të etikës, moralit dhe të mirësjelljes.
- c. Të respektojnë pedagogët, shokët dhe rregullat e mësimit.

- d. Të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese apo ngacmuese ndaj pedagogëve apo studentëve të tjerë, në mjediset e institucionit.
- e. Të mos ofrojnë në asnjë formë, privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, vetë apo nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favorizime të tjera, të cilat pedagogu mund t'i kryejë për shkak të detyrës.
- f. Të mos kopjojnë, të mos bëjnë hile dhe të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve mësimore.
- g. Të mos konsumojnë pije alkoolike apo duhan në ambjentet e institucionit.
- h. Të mos përdorin celular dhe ta mbajë të fiksuar atë gjatë orarit të mësimin në auditor.

Neni 6

Përhapja e dijeve dhe liria akademike

1. Personeli akademik gëzon liri akademike në kërkimet, në punimet shkencore dhe në metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t'i përmbahen përdorimit të përgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performancë të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët.
2. Çdo pedagog duhet të njohë dhe respektojë kontributet shkencore të kolegëve dhe të studentëve. Në leksione, publikime apo prezantime, pedagogët duhet të përdorin praktikën e pranueshme profesionale për materialet e huazuara.
3. Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t'u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit.
4. Çdo pedagog duhet t'u shpjegojë paraprakisht studentëve objektivat e kursit duke e realizuar këtë nëpërmjet leksioneve, demonstrimit, praktikës e provimeve.
5. Pedagogët duhet të tregohen transparentë në vlerësimet dhe testimet e njohurive të studentëve, në metodologjinë e përdorur dhe në rezultatet e tyre.
6. Personeli akademik duhet të shmangë nxjerrjen e informacioneve konfidenciale për studentët pa patur lejen e tyre, përveçse në raste të veçanta kur e parashikon ligji. Çdo informacion për pikëpamjet,

besimet, aktivitetet, shoqatat politike që merren nga bisedat me studentët duhet të ruhen konfidenciale.

Neni 7 Sanksione

Përveç shkeljeve që ndërshkohen nga dispozitat e Statutit dhe të Rregullores së U.T., si dhe të atyre që përbëjnë figurë veprash penale që trajtohen nga dispozitat e Kodit Penal, shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 4 dhe 5 përbën shkelje disiplinore për të cilën parashikohet:

- a. Për shkeljen e pikave a), b), c), d), g), h), i), j) dhe k) të nenit 4 parashikohet ndërshkim me "tërheqje vëmendje", "vërejtje me shkrim", dhe "vërejtje me paralajmërim". Në rast se këto shkelje bëhen të përsëritura, Këshilli i Etikës i propozon autoritetit drejtues, ndërshkime të tjera më të rrepta.
- b. Për shkeljen e pikave e) dhe f) të nenit 4, sipas rastit, parashikohet ndjekje penale, dhe/ose procedim disiplinor deri në largim nga puna.
- c. Për shkeljen e pikave a), b), c), d), g), h) dhe f) të nenit 5 parashikohet ndërshkim me "tërheqje vëmendje" ose përjashtim nga auditori drejtpërdrejt nga vetë pedagogu i lëndës për një periudhë kohe. Në rast se shkelja përsëritet, edhe pas tërheqjes së vëmendjes, studenti mund të pezullohet nga pjesëmarrja në mësim për lëndën përkatëse, deri në marrjen e një vendimi nga dekani ose drejtori.
- d. Për shkeljen e pikës e) të nenit 5, në rast se nuk përbëjnë vepër penale, studentët mund të ndiqen disiplinarisht sipas dispozitave të Statutit dhe të Rregullores së U.T.

Neni 8 Organi disiplinor

Këshilli i Etikës është organi që krijohet dhe funksionon në përputhje me nenin 17 të ligjit për arsimin e lartë, me nenet 28 dhe 29 të Statutit të U.T., si dhe me nenin 15 të Rregullores së U.T. Në zbatim të këtij Kodi, ai ka në kompetencë:

1. Të vëzhgojë zbatimin e dispozitave të këtij Kodi dhe të propozojë ndryshime, përmirësime apo masa të tjera detyruese që kanë të bëjnë me etikën në U.T.
2. Të japë masat disiplinore të parashikuara në pikat a) dhe c) të nenit 7, sipas rastit, në nivel njësie kryesore ose universiteti.
3. Të propozojë procedimin disiplinor të parashikuar sipas pikave b) dhe d) të nenit 7, organit që ka kompetencën të japë masë ndërshkimore sipas Statutit dhe Rregullores.

Neni 9

Denoncimi i shkeljes

Secili person që është subjekt i aplikimit të dispozitave të këtij Kodi ka të drejtë të denoncojë apo raportojë vetë, nëpërmjet eprorit, ose mbrojtësit të studentëve, shkelje të dispozitave të këtij Kodi, përpara anëtarëve të Këshillit të Etikës, autoritetit drejtues të njësisë kryesore ose Rektorit, i cili merr edhe mendimin e Këshillit të Etikës.

Neni 10

Mbledhja dhe funksionimi

Këshilli i Etikës mbledhet dhe funksionon në nivel njësie kryesore (fakulteti/qendre/drejtorie) dhe në nivel universiteti.

Këshilli i Etikës mbledhet të paktën një herë në tre muaj, por kur ka raportime apo denoncime pranë tij, apo nga ana e organeve eprore të tjera, mund të mbledhet edhe më shpesh.

Këshilli i Etikës zhvillon mbledhjet në prani të sekretarit teknik, i cili dokumenton anën protokollare të funksionimit të tij.

Këshilli i merr vendimet me shumicë të thjeshtë dhe ua dërgon për miratim përfundimtar Dekanit/Drejtorit, ose Rektorit sipas nivelit.

Vendimet dhe masat që merren në ushtrim të funksioneve, Këshilli i Etikës i dërgon për regjistrim në zyrën e burimeve njerëzore dhe në zyrën e protokollit e arshivës.

Neni 11

Dispozita përfundimtare

Kodi i Etikës hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik.

KRYETARI
DHORI KULE